



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Arb & Trans 2010” shpk

Adresa: Zall Herr, Çerkezë-Morinë, Ndërtesë 2 katëshe, 100m larg ish Stallavë Çekrezë, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim” ” **Rikonstruksion i rrëshqitjeve anësore në rrugën Muhamet Deliu”.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-24450-05-29-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: ” **Rikonstruksion i rrëshqitjeve anësore në rrugën Muhamet Deliu”.**

Fondi limit: 3,504,742.92 (tre milionë e pesëqind e katër mijë e shtatëqind e dyzet e dy pikë nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion me VKB Nr.49, datë 03.05.2019 ”Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB Nr.159 datë 21.12.2018, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019” (i ndryshuar).

Kohëzgjatja e kontratës: 56 (pesëdhjetë e gjashtë) ditë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 10.06.2019, ora 12:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 22 datë 03.06.2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomike më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Operatori ekonomik “2 N” sh.p.k**

NUIS L31615017L

Vlera e ofertës = **2,583,580** (dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. **Operatori ekonomik “Kombeas” sha.**
K88103301J

NUIS

Vlera e ofertës = **2,626,192.29** (dy milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e dy pikë njëzet e nëntë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Arb & Trans 2010” shpk

NUIS

L02325001T

Vlera e ofertës = **2,921,856.62** (dy milion e nëntëqind e njëzet e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Shamo Konstruksion” sh.p.k

NUIS

L01326020F

Vlera e ofertës = **3,244,822** (tre milion e dyqind e dyzet e katër mijë e tetëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë të mëposhtëm, përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- **Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “2 N” shpk**

NUIS

L31615017L

- Operatori ekonomik “2N” shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/ Kamion me kapacitet mbajtës 10 - 15 ton” pasi Kamioni me targë AA 619KY i deklaruar në Shtojcën 9 si kamion me kapacitet 10-15 ton nga verifikimi i dokumentacionit **rezulton me kapacitet mbajtës 17,8 ton, prambi kapacitetin e kërkuar.**
- Operatori ekonomik ka deklaruar sipas Shtojcës 9 se disponon 1 (një) Autobot uji me targa AA 393PN. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur rezulton se mjeti i sipërcituar është Autobot i certifikuar për transport lënde të rrezikshme, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “2N” shpk, referuar Shtojcës 9 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Kombeas” sha.

NUIS

K88103301J

- Operatori ekonomik “KOMBEAS” sh.a nuk ka paraqitur Shtojcën Nr.4 “Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”, cka bie në kundërshtim me Kriteret e Përgjithshme Të Pranimit/Kualifikimit.
 - Operatori ekonomik “KOMBEAS” sh.a nuk ka paraqitur Shtojcën Nr. 10 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces”, cka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, germa e).
 - Shoqëria “KOMBEAS” sh.a nuk plotëson pikën 4 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Një punësim mesatar i të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) personave, për periudhën Shkurt 2019 - Prill 2019 të vërtetuar me....”, ky operator duhet të ketë në dispozicion për kontratën objekt prokurimi 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës por referuar vërtetimit Nr.T01126816, date 05.06.2019, si dhe referuar kontratave të nënshkruara midis operatorit ekonomik dhe Bashkisë Tiranë me objekt: 1. “Rruga për në fshatin Kasalle (Degëzim nga Cerkezi në Cinam), Loti II”. 2. “Ndërtimi i Trotuarëve në rrugët ”Kasem Shima dhe ”Skënderbe” Mëzez Kodër, të cilat nuk i kanë përfunduar efektet tekniko-financiare, si dhe referuar diferencës midis numrit të punonjesve të anagazhuar në këto kontrata dhe punësimit mesatar të operatorit ekonomik rezulton **një numër i pamjaftueshëm punonjësish.**
 - Operatori ekonomik “Kombeas” sha nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019” pasi **nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019.**
 - Referuar dokumentacionit të paraqitur për stafin teknik, rezulton se Operatori ekonomik “Kombeas” sha, nuk ka deklaruar të punësuar pranë shoqërisë 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
 - Referuar dokumentacionit të paraqitur për stafin teknik, rezulton se Operatori ekonomik “Kombeas” sha, nuk ka paraqitur Diplome mbi punonjësit pllakashtrues dhe punonjës teknik ndërtimi, cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6, ku përcaktohet se: Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:
 - 1 (një) punonjës pllakashtrues
 - 1 (një) punonjës teknik ndërtimi
- Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; **diplomë përkatëse**, dëshmite e kualifikimit të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listagesat e shoqërisë.
- Operatori ekonomik “Kombeas” sha nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/ Kamion me kapacitet mbajtës 10 - 15 ton” pasi

Kamioni me targë AA531 BP deklaruar në Shtojcën 9 si kamion me kapacitet 10-15 ton nga verifikimi i dokumentacionit **rezulton me kapacitet mbajtës 7.8 ton, pra nën kapacitetin e kërkuar.**

- Operatori ekonomik “Kombeas” sha nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/ Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton”. Nga verifikimi i dokumentacioni shoqërues mbi Kamionçinën me targë L 8346 A rezulton se mungon Leja e Qarkullit të mjetit duke e bërë të pamundur llogaritjen e kapacitetit mbajtës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Arb & Trans 2010” sh.p.k**, me adresë: **Zall Herr, Çerkezë-Morinë, Ndërtesë 2 katëshe, 100m larg ish Stallavë Çekrezë, Tiranë** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **2,921,856.62** (dy milion e nëntëqind e njëzet e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë pike gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 11.06.2019

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori ekonomik “2N” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 24751 Prot, datë 17.06.2019 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: **“ Rikonstruksion i rrëshqitjeve anësore në rrugën Muhamet Deliu”.**

Me marrjen e ankesës nga Operatori ekonomik i mësipërm në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 22492/3 Prot, dt. 17.06.2019 është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma “a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 22492/4 Prot, datë 17.06.2019 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave, i cili pasi u njoh me pretendimet e Shoqërisë “2N” shpk konkludoi në mospranimin e ankesës, duke i kthyer pergjigje me shkresën me Nr. 24751/2 Prot , datë 20.06.2019, (administruar ne dosjen e prokurimit).

